



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 18.04.2023

Nr: 58

Ora: 17:30

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 50, DATË 17.04.2023 TË DEPOZITUAR NGA "PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 18.04.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: "Partia Demokratike e Shqipërisë", përfaqësuar nga z. Indrit Sefa

PALË E INTERESUAR: Subjekti zgjedhor koalicioni "Bashkë Fitojmë", përfaqësuar nga z. Altin Kaziaj dhe z. Franci Nuri

OBJEKT: 1. Shfuqizimi i vendimit nr. 361, datë 15.04.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Këshillin e Bashkisë Tiranë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

2. Shfuqizimi i vendimit nr. 362, datë 15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për “Miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtar në Këshillat Bashkiak në 60 bashki për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.”

3. Ndryshimin e përmbajtjes së fletës së votimit duke vendosur të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 98, pika 3 e Kodit Zgjedhor sipas propozimit bashkëlidhur.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

“Partia Demokratike e Shqipërisë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 50 regj., datë 17.04.2023. Në mbledhjen e datës 18.04.2023, ora 17:15, pas relativitetit të z. Koli Bele u konstatua se kërkesa ankimore nr. 50 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi është paraqitur në formën e kërkuar nga KQZ dhe brenda afatit ligjor të parashikuar.

Për sa i përket legjitimitetit të subjektit ankues, KAS çmon se çështja objekt shqyrtimi ka të bëjë me konfigurimin e fletës së votimit. Si një nga subjektet zgjedhore konkurruese në zgjedhje, justifikohet interesi i ligjshëm i “Partisë Demokratike” për të paraqitur kërkesën ankimore.

Gjithashtu, edhe jurisprudenca e mëparshme në shqyrtimin e ankesave nga KAS, lidhur me kompozimin e fletës së votimit, i njeh të drejtën subjekteve zgjedhore që garojnë në zgjedhje dhe rrjedhimisht do jenë pjesë e fletës së votimit, të vënë në lëvizje KAS.

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 50, datë 18.04.2023, të paraqitur nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 19.04.2023, ora 16:30.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar (Kundër)
Ledio	BRAHO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar